

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Nr. _____ prot

Datë 22.07.2019

Për: "Integrated Technology Services" Sh.p.k , adresa Njesia Bashkiake nr 2, Rruga Papa Gjon Pali, Pallati F & G, Ap 15, Tiranë.

Procedura e prokurimit: "Procedurë e hapur" me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-24226-05-28-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Furnizimi dhe instalimi i sistemit automatik të matjes të ujit të pijëshëm në fshatin Mborje" sipas Projektit "Bashkëveprimi ndërkufitar për furnizimin me ujë të pastër nëpërmjet një mjedisi të shëndetshëm" ("SAVE SAFE WATER")

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 22, datë 03.06.2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: X çmimi më i ulët doferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. "Integrated Technology Services" Sh.p.k, NIPT: L02302032C, vlera: 12.841.605 (dymbëdhjetë milionetëqindëzetenjë mijëegjashtëqindëpesë) lekë.
2. "SHENDELLI" Sh.p.k, NIPT: K07924803N, vlera: 9.605.925 (nëntë milionegjashtëqindëpesë mijëenëntëqindënjëzetepesë) lekë.
3. Bashkimi i Operatoreve Ekonomike "XHENGO" SHPK, NUIS:J64103171M + "AURORA KONSTRUKSION" Sh.p.k, NUIS: K02017003I, vlera: 9.886.800 (nëntë milionetëqindëtetëdhjetëegjashtë mijëetëqindë) lekë.
4. " K-AAV " Sh.p.k NUIS: L51506025C, vlera: 12.920.250 (dymbëdhjetë milionenëntëqindënjëzet mijëedëqindëpesëdhjetë) lekë.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. "SHENDELLI" Sh.p.k, NIPT: K07924803N, vlera: 9.605.925 (nëntë milionegjashtëqindëpesë mijëenëntëqindënjëzetepesë) lekë.
2. Bashkimi i Operatoreve Ekonomike "XHENGO" SHPK, NUIS:J64103171M + "AURORA KONSTRUKSION" Sh.p.k, NUIS: K02017003I, vlera: 9.886.800 (nëntë milionetëqindëtetëdhjetëegjashtë mijëetëqindë) lekë.
3. " K-AAV " Sh.p.k NUIS: L51506025C, vlera: 12.920.250 (dymbëdhjetë milionenëntëqindënjëzet mijëedëqindëpesëdhjetë) lekë.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Lidhur me ofertuesin "SHENDELLI" Sh.p.k, KVO, në mbështetje të nenit 46 të Ligjit Nr. 9643 dt. 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" me ndryshime, si dhe të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" Nenit 66 , pika 3

vendosi që "SHENDELLI" Sh.p.k të mos kualifikohej sepse:

1. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë **teknik** të kualifikimit, pika 1 , Shtojca 12 e DT, për realizimin e punëve të ngjashme të së njejtës natyrë , për arsye se "SHENDELLI" Sh.p.k nuk ka paraqitur punë të ngjashme të realizuara, **për furnizim dhe instalim të sistemeve automatik të matjes të ujit të pijëshëm , përfshi instalim dhe konfigurim të matësve elektronik të ujit.**

- Lidhur me Bashkimin e Operatoreve Ekonomike "XHENGO" Sh.p.k +" AURORA KONSTRUKSION" Sh.p.k , KVO, në mbështetje të nenit 46 të Ligjit Nr. 9643 dt. 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" me ndryshime, si dhe të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" Nenit 66 , pika 3, si dhe nenit 74, vendosi që Bashkimin i oe të mos kualifikohej sepse:

1. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë **teknik** të kualifikimit, pika 1 , Shtojca 12 e DT, për realizimin e punëve të ngjashme të së njejtës natyrë , për arsye se nuk ka paraqitur punë të ngjashme të realizuara, **për furnizim dhe instalim të sistemeve automatik të matjes të ujit të pijëshëm , përfshi instalim dhe konfigurim të matësve elektronik të ujit.**

Edhe "AURORA KONSTRUKSION" Sh.p.k e cila ka marrë përsipër se do të kryejë 20 % të punëve: vendosjen dhe kolaudimin e matësve elektronikë si dhe gjërmim, mbushje, nivelim, ngjeshje, kthim në gjëndjen e mëparshme për 30 matësa, nuk ka paraqitur asnjë punë të ngjashme të realizuar, **për furnizim instalim dhe konfigurim të matësve elektronik të ujit.**

Neni 74 i VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 përcakton:

"Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim."

- Lidhur me ofertuesin " K-AAV " Sh.p.k, KVO, në mbështetje të nenit 46 të Ligjit Nr. 9643 dt. 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" me ndryshime, si dhe të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" Nenit 66 , pika 3 vendosi që " K-AAV " Sh.p.k të mos kualifikohej sepse:

1. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë **teknik** të kualifikimit, pika 1 , Shtojca 12 e DT, për realizimin e punëve të ngjashme të së njejtës natyrë , për arsye se "K-AAV" Sh.p.k nuk ka paraqitur punë të ngjashme të realizuara, **për furnizim dhe instalim të sistemeve automatik të matjes të ujit të pijëshëm , përfshi instalim dhe konfigurim të matësve elektronik të ujit.**
2. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë **teknik** të kualifikimit, pika 4/c , Shtojca 12 e DT, për punësimin e një Inxhinieri elektronik (IT), për arsye se oe nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë përmbushjen e këtij kriteri.
3. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë **teknik** të kualifikimit, pika 5 , Shtojca 12 e

DT, për punësimin e katër punonjësve hidraulikë, për arsye se oe nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë përmbushjen e këtij kriteri.

4. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë **teknik** të kualifikimit, pika 6 , Shtojca 12 e DT, për arsye se oe nuk ka paraqitur kontrata pune për katër punonjës manovratorë.
5. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë **teknik** të kualifikimit, pika 8 , Shtojca 12 e DT, për arsye se oe nuk ka paraqitur Çertifikatë per Sistemin e manaxhimit te mjedisit ISO 14001:2015 .
6. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë **teknik** të kualifikimit, pika 9 , Shtojca 12 e DT, për arsye se oe nuk ka paraqitur Çertifikatë per Sistemin e manaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune OHSAS 18001 .
7. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë **teknik** të kualifikimit, pika 10 , Shtojca 12 e DT, për arsye se oe nuk ka paraqitur dokumenta që të vërtetojnë që ka në dispozicion të gjitha mjetet teknike të kërkuara : 2 Eskavatorë me goma si dhe 2 Kamiona 2,5 ton -6 ton.
"K-AAV" Sh.p.k ka deklaruar dhe ka paraqitur dokumenta dëshmues se, nga mjetet e kërkuara të sipërcituara, ka në dispozicion vetëm nga një copë, nga 2 copë të kërkuara.
8. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë **ekonomik** të kualifikimit , pika 1, Shtojca 12 e DT, sepse sipas Vërtetimit Nr. 11781 Prot, datë 11.03.2019 të paraqitur nga "K-AAV" Sh.p.k rezulton që xhirot mesatare vjetore në vitin 2018 si dhe në vitin 2016 janë 0 lekë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë "Integrated Technology Services" Sh.p.k , adresa Njesia Bashkiake nr 2, Rruga Papa Gjon Pali, Pallati F & G, Ap 15, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 12.841.605 (dymbëdhjetë milionet e tetëqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e pesë) lekë është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë UKKO Sh.A, adresa Rajoni Nr. 1, Rruga Boris Plumbi, Korçë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 12.07.2019.

Ankesa: nuk ka.

* * *

ZYRTARI I AUTORIZUAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Elia Pendavinji